




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.73/2024
Datë: 29 mars 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 22 par. 6 dhe nenit 24 të Rregullores Nr. 04/2021 për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, në takimin 323-të, të mbajtur me datë 29 mars 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Konfirmohet lista përfundimtare e kandidatëve të përzgjedhur për bashkëpunëtorë profesional në gjykatat e Republikës së Kosovës.
- II. Bashkëpunëtorët profesional do të fillojnë punën në gjykatat e Republikës së Kosovës, nga data 2 prill 2024.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 29 mars 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me vendimin KGJK.nr.472/2023, të datës 31 tetor 2023, ka shpallur konkurs për rekrutimin e dyzetë (26) pozitave të lira për bashkëpunëtorë profesional në gjykatat e Republikës së Kosovës.

Këshilli lidhur me mbarëvajtjen e procesit të rekrutimit të bashkëpunëtorëve profesional, ka pranuar raport nga komisioni për rekrutim, së bashku me listën përfundimtare dhe profilin e të dhënave për secilin kandidat. Këshilli, pas shqyrtimit dhe analizimit të raportit, konfirmoi listën e kandidatëve të përzgjedhur për bashkëpunëtorë profesional në gjykatat e Republikës së Kosovës.

Nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Njesisë për Inspektim Gjyqësor;
- Sekretariatit të KGJK-së dhe
- Arkivit.